

Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupstina Opstine/Municipal Assambly

Bazuar ne rekomandimin e MMPH-së, Nr. 5455-2/26 i datës; 19.05.2026, në mbështetje të nenit 11, dhe 12 nën paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 shkronja b), neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja l), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 5 paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2.1, neni 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, neni 11 dhe neni 15 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, neni 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3.1 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe neni 14 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 i dt.03.12.2008, Kuvendi i Komunës ne mbledhjen e rregullt te mbajtur me datën; **29.05.2026**, mori këtë:

VENDIM PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË SKENDERAJT 2026 -2034

Neni 1

Miratohet propozim – vendimi nr. 02-351/01-0014193/26, i datës, 21. 04.2026, për rishqyrtimin e Vendimit për inicimin e procedurës së hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajt 2026-2034, me Nr. 01-351/01-0008195/26, i datës ; 03.03.2026. i miratuar në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Skenderajt të datës; 27.02.2026, ky rishqyrtim i vendimit të lartcekur riformulohet në bazë të rekomandimit të MAPL-së, Nr. 1128-2/26 i datës; 19.03.2026, si në vijim;

Neni 2

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal i Skenderaj.

Neni 3

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal në harmoni me ligjin si Plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 4

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1. i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Skenderaj, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin strategjik multi-sektorial, i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 5

Kufiri i territorit

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Skenderaj janë :

Nr.	Zona Kadastrale	Sipërfaqet		
		ha	a	m2
1	Baks	537	44	94
2	Bajë	1033	20	12
3	Burojë	1191	99	37
4	Çirez	681	66	22
5	Çitak	266	10	1
6	Çubrel	1105	62	39
7	Klinë e Poshtme	485	39	21
8	Abri e Poshtme	1074	23	41
9	Prekaz i Poshtëm	580	97	84
10	Kopiliq i Poshtëm	942	52	30
11	Dashec	177	43	82
12	Klinë e Epërme	885	45	31
13	Prekaz i Epërm	1177	6	83
14	Kopiliq i Epërm	419	78	3
15	Izbicë	687	44	10

16	Klladernicë	1176	57	19
17	Kostërc	572	76	92
18	Kotorr	899	66	15
19	Kozhicë	445	75	21
20	Kralicë	733	60	45
21	Krasaliq	317	67	89
22	Krasmiroc	388	59	17
23	Kryshec	326	37	0
24	Kuçicë	1156	90	57
25	Llaushë	2196	29	19
26	Leçinë	784	18	58
27	Likoc	714	46	52
28	Lubavec	638	24	25
29	Makërmal	558	93	56
30	Marinë	325	6	48
31	Mikushnicë	726	85	19
32	Murgë	328	54	97
33	Novosellë	203	24	45
34	Ovçarevë	1252	71	2
35	Pemishtë	223	64	84
36	Plluzhinë	536	87	8
37	Polac i Vjeter	694	5	52
38	Polac i Ri	767	29	41
39	Prelloc	299	76	58
40	Radishevë	1263	35	38
41	Rakinicë	652	14	8
42	Rezallë	1407	98	74
43	Runik	1137	8	97
44	Skenderaj	465	77	41
45	Klinë e Mesme	407	35	32
46	Syriganë	677	60	92
47	Ticë	414	53	42
48	Tërnavc	620	0	80
49	Turiqec	663	17	66
50	Tushilë	280	4	96
51	Vitak	580	77	3
52	Vajnikë	1257	56	47
	Totali	37316	2560	2325

Neni 6

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal është Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit) në koordinim me drejtorit sektoriale dhe burimet njerëzore brenda Komunës.

Neni 7

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Mjetet për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Skenderaj Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës.

Neni 8

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1. të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor të hartojë në afat brenda 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 9

Konsultime Publike

Projekti i Planit Zhvillimor Komunal para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Planit Zhvillimor Komunal në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 10

Afati i Vlefshmërisë

Dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 11

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 12

Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11. pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174.

Neni 13

Hyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi, 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb – faqen të Komunës.

Bashkangjitur;

- **Programi për Hartimin dhe Menaxhimin e Procesit të Planifikimit 2026-20232 (pjesë e vendimit)**


Vendimi i Dërgohet :

1x1 DUMA,
1x1 MAPL-së,
1x1 Zyrës së Kryetarit,
1x1 Arkivit,
1x1 Dosjes.

KRYESUESJA E KUVENDIT

znj. Adelina Spahiu-Alija





Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderaj Adelina Spahiu-Alia, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderaj	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH	
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH	VL 117/26 Datë: 10.06.2026
Zyrtarët përgjegjës:		
1.Zyrtari konfirmues vlerësimit ligjor	Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e	
2.Zyrtari hartues vlerësimit ligjor	Përfaqësimeve Gjqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit	
Lloji i aktit:	Vendim Nr.01-351/01-0020582/26 për hartimin e planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajit 2026-2034	

I nderuar kryetar Lushtaku,
E nderuar kryesuese Spahiu-Alija

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 08.06.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendimin Nr.01-351/01-0020582/26 për hartimin e planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajit 2026-2034**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave:

KONFIRMON

Vendimin Nr.01-351/01-0020582/26 për hartimin e planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Skenderajit 2026-2034

ARSYETIMI

MMPH pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Kuvendi Komunal i Skenderaj ka vepruar në përputhje duke reflektuar rekomandimet e dhëna në vlerësimin e ligjshmërisë Nr. Prot. 5455-2/26, datë 19.05.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor mbetet në dispozicion të Komunës së Skenderaj dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

